FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

KLORUR KALIUMI

Tretësirë për injeksion – 750 mg / 10 ml, 375 mg / 5 ml
(Klorur kaliumi)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.
- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:
1. Çfarë është Klorur kaliumi dhe përse përdoret
2. Përpara se të merrni Klorur kaliumi
3. Si ta merrni Klorur kaliumi
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Klorur kaliumi
6. Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË KLORUR KALIUMI DHE PËRSE PËRDORET

Kaliumi merr pjesë në një numër procesesh fiziologjike thelbësore, siç janë mbajtja e tonicitetit brendaqelizor dhe një raport i përshtatshëm me natriumin në membranën qelizore, metabolizmi qelizor, përçimi i impulseve nervore, tkurrja e muskujve të zemrës, të skeletit dhe muskujve të lëmuar; barazpesha acido – bazike dhe mbajtja e funksionit normal të veshkave. Nivelet normale të kaliumit në serum luhaten nga 3.5 deri në 5 milibarazvlerës / L.
Klorur kaliumi indikohet në korrigjimin e hipokalemisë së rëndë dhe kur nuk mund të merren nga goja sasi të mjaftueshme kaliumi.

2. PËRPARA SE TË MERRNI KLORUR KALIUMI

Mos merrni Klorur kaliumi nëse:
- vuani nga dëmtim i rëndë i funksionit të veshkave me oliguri ose azotemi;
- vuani nga sëmundje e pamjekuar e Adisonit;
- vuani nga hiperkalcemi, pavarësisht nga shkaku;
- vuani nga *adynamia episodica hereditaria;* dehidrim akut;
- merrni diuretikë mbajtës të kaliumit ose lëndë që e frenojnë aldosteronin.

Tregoni kujdes të veçantë me Klorur kaliumi
Pyesni mjekun tuaj përpara se të merrni Klorur kaliumi:
- në qoftë se jeni të moshuar ose të sëmurë me dëmtim të funksionit të veshkave;
- në qoftë se jeni të sëmurë me sëmundje zemre.

Matjet e vazhdueshme të përmbajtjes së kaliumit në plazmë janë të nevojshme për të përcaktuar nëse duhen bërë perfuzionime të mëtejshme, me qëllim që të mënjanohet zhvillimi i hiperkalemisë.

3. SI TA MERRNI KLORUR KALIUMI

Gjithmonë merreni Klorur kaliumi sipas këshillës së mjekut. Në qoftë se nuk jeni i sigurt, kontaktoni me mjekun ose farmacistin. Në qoftë se ndjeni që efektet e Klorur kaliumi janë shumë të forta ose shumë të dobëta, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj.
Klorur kaliumi *mund të përdoret si më poshtë:*
Me perfuzionim në venë: Në varësi nga defiçiti ose kërkesa ditore për kalium.
Tretësira 7.5% duhet hollua me jo më pak se 25 herë vëllimin e saj me tretësirë për injeksion klorur natriumi 0.9% ose ndonjë tretësirë tjetër të përshtatshme dhe pastaj të përzihet mirë.

Në qoftë se keni marrë më shumë Klorur kaliumi
Në qoftë se keni marrë më shumë Klorur kaliumi se sasia që duhet të merrnit, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin, ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren.

Në qoftë se harroni të merrni Klorur kaliumi
Në qoftë se harroni një dozë (ose më shumë doza), merrni dozën në vazhdim kur të jetë koha për marrjen e zakonshme të saj. Mos merrni një dozë të dyfishtë (ose më të lartë) për të plotësuar dozën (dozat) e harruar(a). Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Si të gjitha barnat e tjera, Klorur kaliumi mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston. Pjesa më e madhe e efekteve anësore janë të lidhura me dozën dhe zhduken kur doza reduktohet ose trajtimi ndërpritet. Disa efekte anësore mund të ndodhin në fillim të trajtimit dhe zhduken në mënyrë spontane me vazhdimin e mjekimit.
Ndonjëherë, sidomos kur injektohen sasi të theksuara tretësire, mund të shfaqet:
- hiperkalemi që shoqërohet me parestezi të ekstremiteteve,
- konfuzion,
- hipotension,
- aritmi,
- bllok kardiak,
- ndërprerje e punës së zemrës,
- interval QT i zgjatur,
- të përziera, të vjella,
- oliguri, anuri,
- ekzantema.

Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore përkeqësohet, ose në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk përmenden në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të lajmëroni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TA RUANI KLORUR KALIUMI

Mbajeni larg fëmijëve!
Mos e përdorni Klorur kaliumi pas datës së skadimit e cila është e shënuar në paketim.
Mos e ruani mbi 25°C!
Ruajeni në paketimin origjinal për ta mbrojtur nga drita!

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmban Klorur kaliumi – Tretësirë për injeksion
Lënda vepruese është Klorur kaliumi.
Çdo ampulë 5 ml përmban 375 mg klorur kaliumi.
Çdo ampulë 10 ml përmban 750 mg klorur kaliumi.
Përbërës të tjerë: ujë për injeksion.

Përmbajtja e paketimit
Ampula 5 ml ose 10 ml:
Kuti me 10 ampula;
Kuti me 100 ampula (përdorim spitalor).

Shpjegues i ikonave ilustruese për paketim:

Sipas recetës së mjekut.

Përmbajtja. Kujdes.

Tretësirë për injeksion.

Mbajtësi i autorizimit për tregtim (MAT) dhe prodhuesi:

PROFARMA Sh.a.
Rruga "Myslym Keta"
Tel.: 00 355 4 23 89 602
Tiranë - SHQIPËRI

Ky fletëudhëzues u rishikua për herë të fundit në Dhjetor 2011.

SPECIFICATION

CROPING AREA 12 x 19 cm

PAY ATENTION, all the layers are visible.
If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.